

**ФОНДАЦИЈА  
ЗА РАЗВОЈ НА  
ЛОКАЛНАТА  
ЗАЕДНИЦА**



**LOCAL  
COMMUNITY  
DEVELOPMENT  
FOUNDATION**



**LOCAL  
DEVELOPMENT  
AGENCY  
STRUGA**

## **DOKUMENTI I POLITIKËS PUBLIKE**

# **PËRDORIMI I MEKANIZMAVE PËR KONSULTIM TË QYTETARËVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE NË NIVELIN LOKAL**

**Krsitina Haxhi – Vasileva**

Maqedonia, korrik 2017

**Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian në korniza të Instrumentit për demokraci dhe të drejta të njeriut EuropeAid/136-518/DD/ACT/MK.**



Projekt: Përdorcimi i demokracisë pjesëmarrëse

Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian

Përfshirja e qytetarëve në proceset e miratimit të vendimeve është në lidhje të ngushtë me decentralizimin. Decentralizimi i suksesshëm kërkon një nivel të lartë të pjesëmarrjes së bashkësisë lokale në këto procese. Autoritetet lokale, që janë me orientim për të komunikuar në mënyrë efikase me qytetarët, janë në pozitë që të shërbejnë qytetarëve dhe të fokusohen prioriteteve “të vërteta” dhe me atë në mënyrë efikase që të përdorin buxhetet e komunave. Për shkak të kësaj, komunikimi midis qytetarëve dhe autoriteteve komunale duhet të zhvillohet përmes mekanizmave institucionale që mund të përshtaten dhe të përmirësohen. Për qytetarët kjo paraqet një mundësi që të përfshihen dhe të ndikojnë në problemet që kanë efektin e drejtpërdrejtë në jetën e përditshme, dhe për autoritetet një mundësi për rritjen e mbështetjes për idetë e tyre dhe për të gjetur mënyra të reja, inovative për zgjidhjen e problemeve.

Çdo përpjekje, tema e pjesëmarrjes civile që të futet në pah në politikat publike që kanë për qëllim përmirësimin e mekanizmave ekzistuese pjesëmarrëse ose miratimi i mekanizmave të reja, në përgjithësi, në bazë të tyre duhet të kenë një kornizë të fortë të të dhënave sasiore dhe cilësore. Duke marrë parasysh këtë, dokumenti i politikës publike (i krijuar në bazë të Analizës së praktikave ekzistuese për përdorimin e mekanizmave për konsultim me qytetarët në zhvillimin e politikave publike në nivel lokal dhe efikasitetin e tyre dhe konkluzionet nga grupet rajonale punuese) ka për qëllim që të jepet informacione në procesin e krijimit të intervenimeve të ardhshme për përmirësimin e këtyre mekanizmave dhe për të rritur demokracinë pjesëmarrëse në Maqedoninë.

Analiza, gjithashtu, do të ofrojë mbikëqyrje në përdorim të mekanizmave ekzistuese edhe nga ana e qytetarëve edhe nga ana e autoriteteve lokale, efektet e përdorimit të tyre dhe si e këtillë, do të ofrojë të dhëna që mund të kontribuojnë për një debat më të gjerë publik për problemin e ndryshimeve ligjore. Gjithashtu, mund të shërbejë si një mjet për lobim në komunat për të implementuar mjete të reja dhe më të ndryshme për konsultim.

Qëllimet konkrete të analizës janë në vijim:

1. Të analizohet gjendja aktuale në lidhje me mekanizmat për konsultim të qytetarëve në procesin e krijimit të politikave publike në nivel lokal;
2. Të mundësohet një diskutim midis pjesëmarrësve lokal (NJVL, OQ dhe SB);
3. Të stimulohet ndarja dhe riplikimi i praktikave të mira të mekanizmave për konsultim midis NJVL-ve;
4. Të lobohet te NJVL-të për institucionalizimin e mekanizmave të propozuara.

Këto qëllime janë në përputhje me përpjekjet e BE-së që të mbështetet dhe promovohet demokracia dhe të drejtat e njeriut përmes përfundimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe përfaqësuese, përfundimit të tërë ciklit demokratik, veçanërisht përmes rolit të përfunduar aktiv të shoqërisë civile në këtë cikël, dhe sundimit të ligjit. Kjo temë është në lidhje të ngushtë me procesin e zgjerimit të BE-së.

## Përmbledhja ekzekutive

Konsultimi me qytetarët është parakushti kryesor për të praktikuar sundimin pjesëmarrës dhe transparent. Bazohet në idenë qytetarët që të përmirësojnë jetën e tyre përmes ideve të tyre, pjesëmarrjes dhe zhvillimit administrativ të vetëqeverisje lokale transparente, së cilës mund të besohet.

Format themelore e konsiliumit me qytetarët janë të elaboruara në dokumente ligjore të miratuara në vend, edhe në nivelin nacional, edhe në nivelin lokal. Megjithatë, nuk ekzistojnë kufizime të metodave që autoritetet lokale mund t'i përdorin në kërkesën e kontributit civil për të gjitha pyetje në korniza të kompetencave të tyre.

Analizon shqyrton nivelin dhe dimensionet e ndryshme të mekanizmave të pjesëmarrjes civile, duke u fokusuar në mënyrë primare në perceptimet e përfaqësuesve të autoriteteve lokale dhe qytetarëve, si edhe në përvojat e tyre, dhe cilat strategji i kanë në dispozicion në trajtimin e procesit të konsultimit. Gjithashtu, shqyrton edhe efektet nga përdorimi i këtyre mjeteve.

Gjetjet janë në bazë të rezultateve nga 412 interviste me qytetarë nga rajone të ndryshme të vendit, 32 intervista të strukturuar me pjesëmarrës relevant (kryebashkiakët dhe këshilltarë komunal) nga të gjitha 8 rajone të Maqedonisë dhe 8 fokus grupe rajonale (OQ, gazetarë, biznesmenë, etj.) me 105 pjesëmarrës.

Analiza tregon se ekziston një mendim në mes të qytetarëve se autoritetet lokale bëjnë përpjekje për të konsultuar me qytetarët. Përpjekjet janë më të mëdha dhe më efikase kur bëhet fjalë për të informuar qytetarët për punën e vetëqeverisë lokale. Në atë aspekt, komunat përdorin të gjitha mjete në dispozicion për të shpërndarë informacionet për (zakonisht aspektet pozitive) punën e kryebashkiakëve dhe shumica e qytetarëve kanë një paraqitje të përgjithshme për atë çfarë punon vetëqeverisja e tyre lokale.

Kur bëhet fjalë për përfshirjen e qytetarëve si partnerë të barabartë në procesin e miratimit të vendimeve, situata është sfiduese. Edhe qytetarët edhe autoritetet lokale në dispozicion kanë mjete dhe mekanizma të paraqitura në dokumentet ligjore, por megjithatë përmbahen nga përdorimi i tyre. Dy palët konsiderojnë këto mekanizma si të komplikuar për përdorim për shkak të procedurave ligjrisht të detyrueshme që duhet t'i përmbajnë. Si rezultat i kësaj, qytetarët i iniciojnë rrallë, dhe autoritetet lokale në mënyrë selektive përdorin dhe privojnë nga karakteristikat ligjore, që do të thotë se përdorin në formë të thjeshtësuar dhe të përshtatur. Kështu, referendum, iniciativë civile dhe mbledhje e qytetarëve, pothuajse kurrë nuk përdorin si mjete për konsultim në formatin e paraparë.

Qytetarët preferojnë kontaktin e drejtpërdrejtë me mbartësit e vendimeve. Përfaqësuesit e autoriteteve lokale, gjithashtu, pranojnë këtë qasje dhe e konsiderojnë të si më efikase, dhe, për shkak të kësaj, mbledhjet e qytetarëve (zakonisht në nivel të komunitetit lokal/urban), deri më tani kanë paraqitur forma më e shpeshtë e konsultimit me qytetarët, si edhe takime të drejtpërdrejta me autoritetet lokale në ditët e hapura ose tribunat publike. Përveç mjeteve dhe mekanizmave ligjrisht të ofruara, të dy palët përdorin edhe forma të tjera të konsultimit, si forume në bashkësinë, mediat sociale (Facebook, Twitter) dhe faqet e internetit (forume) zakonisht të shkaktuara nga donatorët dhe OQ-at.

Buxheti, zhvillimi i planeve urbanistike si edhe investimet kapitale janë temat për të cilat qytetarët interesohen më së shumti, shtesë interesohen edhe për veprimtaritë komunale dhe për infrastrukturën lokale. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale janë të vetëdijshëm për këtë, por shumë shpesh konsultimi me qytetarët për këto çështje është sipërfaqësor dhe e përdorën atë si alibi para organeve të autorizuar, se ata veprojnë dhe arrijnë rezultate. OQ konsiderojnë se autoritetet lokale zakonisht përfshijnë qytetarët në raste nga të cilat kanë dobi të drejtpërdrejtë, si aplikimi për fonde të donatorëve ose për shfrytëzim të ekspertizës së organizatave qytetare gjatë zhvillimit të strategjive të ndryshme tematike (ZhEL, mjedisi, barazia gjinore, etj.).

Qytetarët, nga ana tjetër, tregojnë interes shumë të vogël të pjesëmarrjes. Numri më i madh i qytetarëve në përgjithësi nuk kanë qasur vetëqeverisjes së tyre lokale për problemet nën kompetencën e tyre, siç ishte theksuar edhe në rezultatet nga anketa dhe nga intervistat me kryebashkiakët dhe këshilltarët. Kjo mund të lidhet drejtpërdrejtë me efektet nga pjesëmarrja dhe vendimi që të ndërmerret një veprim. Është shqetësues fakti se presioni mbi grupet civile dhe OQ rrallë tregon rezultate në dobi të qytetarëve. Shpesh ndodhet rezultatet që të jenë tërësisht të kundërta se ajo për të cilën janë rënë dakord qytetarët dhe mbajtësit e vendimeve. Kjo, në mënyrë reciproke, dekurajon njerëzit që të aktivizohen dhe të iniciojnë ndryshime.

Kryebashkiakët dhe organizatat qytetare konsiderojnë se mjetet e ofruara ligjore dhe mekanizmat për konsultim me qytetarët nuk janë të përshtatura në mënyrë të mjaftueshme në realitetin, si p.sh., kushtet për organizimin e referendumit, dhe apelojnë për tejkalimin mangësive dhe mungesave të sistemit.

Me qëllim që të operacionalizohen mekanizmat mbrojtëse për konsultim civil në krijimin e politikave publike në nivel lokal, ishin bërë 8 grupe rajonale pune (nga një në çdo rajon). Përfaqësuesit e VL-ve, OQ-ve dhe qytetarëve të interesuar kanë biseduar për ide konkrete për atë si të përmirësohet pjesëmarrja e qytetarëve në zhvillimin e bashkësisë. Diskutimi midis pjesëmarrësve kryesor lokal siguroi mendime të ndryshme që të merren parasysh gjatë hartimit të rekomandimeve konkrete që do të krahasohen dhe që do të jenë në dobi, edhe për qytetarët, edhe për komunën. Konkluzionet nga puna e grupeve rajonale të punës janë treguar më tej në rekomandimet.

Përveç fakti se pjesëmarrja civile është shumëdimensionale, qasja për trajtim me këtë problem kompleks, kërkon shumëllojshmëri e veprimeve. Këtu përfshihen përpunimet e legjislationit aktual, definimi i mjeteve shtesë, edukimi i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe mekanizmat në dispozicion për mbrojtje, si edhe motivimi për përdorim të tyre.

## Konkluzione dhe rekomandime

Pjesëmarrja e qytetarëve është një nga parakushtet kryesore për të praktikuar demokracia e drejtpërdrejtë dhe për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në bashkësinë. Mund të ketë forma dhe norma të ndryshme, por qëllimi kryesor mbetet i njëjtë, dhe ai është, që të ofrojë platforma të ndryshme qytetarëve për të përfshirë, që të dëgjohen problemet e tyre dhe nevojat, si edhe ide dhe zgjidhje të mundshme të reja, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i bashkësive.

## Konkluzionet

Gjatë kësaj analize të vëllimit dhe politikave aktuale në lidhje me çështjen për konsultimin e qytetarëve gjatë miratimit të vendimeve në nivel lokal, ishin zbuluar shumë mangësi, të cilat kërkojnë vëmendje urgjent nga ana e institucioneve shtetërore dhe lokale.

Konkluzionet kryesore janë në vijim:

- Legjislacioni aktual dhe politikat dështojnë që të sigurojnë mekanizma të lehta për pjesëmarrje të qytetarëve, që gjithashtu, do të marrin parasysh nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve.
- Gjinia, klasa, përkatësia etnike, aftësi të kufizuara, janë ndarjet sociale të ndërlidhura mes vete, që tregohet në marrëdhënie të caktuara shoqërore që i bëjnë anëtarët e grupeve të rrezikuara më të përjashtuara në tregimin e nevojave të tyre. Për të zbuluar nevojat e grupeve të caktuara të qytetarëve, si edhe për të kuptuar problemet e tyre, është domosdoshme që të përdoren qasje të caktuara të përshtatura. Në këtë kontekst, popullsia rome dhe gratë nga mjediset rurale në Maqedoni janë më të rrezikuara, si edhe personat me nevoja të posaçme.
- Pjesëmarrja e qytetarëve perceptohet më shumë si proces i informimit të qytetarëve për punën e vetëqeverisjes lokale, ndërsa pjesëmarrja në procesin e miratimit të vendimeve është vënë në sjelljen individuale, dhe jo në një problem më të madh shoqëror.
- Komunat nuk janë të detyruara me ligj dhe mund të zhvillojnë mekanizma të vete për të përfshirë qytetarët në përputhje me rrethanat në bashkësi.
- Organizatat qytetare nuk janë mjaft të fuqishme që të ndikojnë mbi çështjet në lidhje me mirëqenien e qytetarëve.
- Qytetarët nuk janë të motivuar që të bëhen qytetarë aktiv, sepse ata shpesh janë të manipuluar dhe iniciativat e tyre janë të anashkaluara.

## Rekomandimet

### 1. Ndryshimet ligjore

#### **Rekomandime:**

- Ndryshimi/Rregullimi i detyrave ligjore për implementimin e të gjitha reformave të pjesëmarrjes civile. P.sh., pranimi i shumicës së votuesve në referendum pavarësisht numrit të votuesve.
- Që të bëhet regjistrim në nivel nacional. Kjo do të ndihmojë implementimin e mjeteve dhe mekanizmave ligjorisht të definuara të pjesëmarrjes civile duke mundësuar përdorimin përkatës së kritereve të pjesëmarrjes. P.sh., do të sigurojë një numër të saktë që është në lidhje me 10% të votuesve të regjistruar të bashkësisë.
- Që të zhvillohen dhe përfshihen forma shtesë të pjesëmarrjes civile në statutet e komunave, me qëllim që të formohet një detyrë për përdorimin e tyre dhe që të mbahet përgjegjësia e autoriteteve lokale. Nuk ekzistojnë kufizime ligjore për kreativitetin e komunave gjatë krijimit të modeleve për përfshirjen e qytetarëve. Një proces të këtillë tashmë ka filluar me forumet në bashkësi.
- Rregullimi/Rishqyrtimi i statusit të njësive urbane/lokale në korniza të reja ligjore dhe sigurimi i udhëtimeve të përmirësuara të detajuara për punën e tyre, duke përfshirë edhe detyrat ligjore si edhe pasojat e tyre.
- Që të sigurohet një inkurajim për përsheptimin e procesit të decentralizimit dhe përdorimi i gjendjes aktuale status quo.
- Që të formohen kushte dhe mekanizma për përcaktim të qartë mes partive politike dhe aktiviteteve komunale, për të kufizuar mundësia për abuzim të fondeve komunale për aktivitetet e partive politike.

## 1. Autoritetet lokale

Analiza tregon se ndryshimi i kulturës organizuese dhe përkushtimi ndaj pjesëmarrjes së vërtetë civile është një sfidë, që është e rrënjësor strukturale në institucionet e sistemit, dhe ne presim se këtu ndryshimet e propozuara do të jenë pjesa më e vështirë e realizimit, sepse në këtë sferë ishin identifikuar shumica e mungesave.

### **Rekomandime:**

- Të iniciohen dhe përdoren mjete të ndryshme për pjesëmarrje të qytetarëve, jo vetëm ato që janë treguar në ligjin. Kjo mundëson komunave që të jenë kreative dhe inovative duke konsultuar me qytetarët. Gjithashtu, që të krijohen qasje të përshtatura për zbulimin e nevojave të grupeve të caktuara dhe për të kuptuar problemet e tyre. Në këtë kontekst, më të rrezikuara janë popullsia rome, gratë nga mjediset rurale të Maqedonisë dhe personat me aftësi të kufizuara.
  - *Ditët e hapura* të komunës që të institucionalizohen si mekanizëm i detyruar i konsultimit me qytetarët në një periudhë e caktuar nga më parë gjatë vitit;
  - Që të formohen Grupe këshillëdhënëse të qytetarëve, që do të punojnë në çështje të caktuara me interes të bashkësisë;
  - Konsultimi i detyruar me qytetarët gjatë miratimit të strategjive dhe planeve;
- Që të mundësohet një qasje më të lehtë deri te mjetet ekzistuese të pjesëmarrjes civile nga ana e qytetarëve dhe organizatave civile, përmes përmirësimit të tyre. P.sh., që të ndryshohet praktika e paraqitjes së planeve të detajuara urbanistike komunale në mënyrë mekanike dhe gjatë diskutimeve të mos përdoren terma teknike me qëllim që të lë hapësirë qytetarët që të ekspozojnë problemet e tyre dhe gjatë kësaj që të kihet mjaft kohë për diskutim dhe paraqitje të planeve urbanistike; që të sigurohet një lokacion të përshtatshëm dhe të gjerë për mbledhje publike; që të sigurohen dokumente kyçe siç është buxheti komunal në një format që do të jetë i kuptueshëm për qytetarët.
  - Në mënyrë të detyrueshme informimi i drejtpërdrejtë dhe personal i qytetarëve që janë të përfshirë drejtpërdrejtë me ndryshimin e planit të detajuar urbanistik (PDU);
  - Hartimi i një paraqitje të qartë dhe me figura për ndryshimet e PDU-it, me 3D paraqitje, që do të jenë të kuptueshme për qytetarin e zakonshëm;
  - Gjatë ndryshimit të PDU-it në mënyrë të detyrueshme hapet një debat të gjerë në të cilin do të marrin pjesë arkitektë, artistë, ekspertë nga sfera të caktuara dhe qytetarë;
  - Hartimi i buxhetit civil, që do të jetë i kuptueshëm dhe i lexueshëm për qytetarin e zakonshëm, i shqyrtuar me grafikë, prezantime, figura, etj.;
  - Hapja e detyrueshme në kohë të debatit publik gjatë fazës së projekt-buxhetit;
  - Komunitat që të praktikojnë implementimin e pikave konkrete në Buxhetin në lidhje me pyetje të caktuara që janë karakteristike për komunën e tyre;
  - Komunitat që të parashikojnë një buxhet për konsultim me qytetarët;
- Që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në organet e vetëqeverisjes lokale. Kjo mund të bëhet me plotësimin e komisioneve aktuale siç janë Komisioni i mundësive të barabarta të meshkujve dhe grave dhe Komisioni për marrëdhënie mes bashkësive me përfaqësues të organizatave qytetare dhe qytetarëve. Shtesë, këto komisione, brenda mandatit të tyre, duhet t'i shqyrtojnë të gjitha plane për punë të komunës dhe ndërmarrjet e saj për të përfshirë parimin e barazisë gjinore/etnike, si edhe që të vëzhgojnë implementimin e tij. Kjo, gjithashtu, është në përputhje me miratimin dhe përdorimin e qasjeve të posaçme për grupe specifike brenda bashkësisë nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale.
  - Plani/Orari i punës së takimeve të Këshillit në kohë që të publikohet në më shumë medime dhe të lajmërohen organizatat lokale civile;
  - Pjesëmarrje më e gjerë në organet e komunës, duke përfshirë anëtarët e jashtme të profesionit profesional dhe qytetarë brenda Komisioneve të Këshillit të komunës




- Plane vjetore të punës (aktivitetet e tyre kryesore) të ndërmarrjeve publike komunale duhet të paraqiten dhe të diskutohen me publikun.
  - Që të rritet transparenca e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike, duke publikuar në mënyrë të rregullt raportet financiare dhe raportet narrative vjetore edhe përmes informacioneve në dispozicion publik për strukturën e menaxhimit;
  - Programet vjetore për punë dhe raportet vjetore të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike në mënyrë të detyrueshme që të bëhen objekt i debatit publik i hapur për çdo qytetar;
- Fokusi që të ndryshohet, nga informimi i qytetarëve, në përfshirjen e tyre në procesin e miratimit të vendimeve, në identifikimin e problemeve, ofrimi dhe diskutimi i zgjidhjeve, implementimi i zgjidhjeve të miratuara në mënyrë të përbashkët, vëzhgimi dhe raportimi.
  - Transparenca më e madhe dhe informimi në kohë qytetarëve për të gjitha aspekte të problematikës konkrete para se të miratohet vendime përfundimtare. Qytetarët duhet të njihen në kohë për gjërat pozitive dhe negative, që një investim/politikë të caktuar do të shkaktojë;
  - Që të përmirësohet funksionaliteti i faqeve të internetit të komunave, duke vendosur informacione në dispozicion të lehtë të hapura për përpunim;
  - Që të përmirësohet qasja për informim dhe përfshirje të grupeve specifike dhe të marginalizuara të qytetarëve dhe qytetarëve nga mjediset rurale;
  - Komuna që të implementojë një praktikë të informacionit të detyrueshëm të kthyeshëm për rezultatin nga iniciativat e parashtruara nga ana e qytetarëve;
- Përmirësimi i partneriteteve me organizatat qytetare.
  - Komuna më shpesh përdor mundësinë për të përcaktuar kompetenca organizatave qytetare;
  - Që të zhvillohet metodologji për ndarje të fondeve organizatave qytetare nga buxheti i komunës, me një procedurë të caktuar saktë dhe kritere të zgjidhjes;
  - Që të përforcohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale me organizatat qytetare dhe që të mundësohen kushte për punë të organizatave lokale;
- Këshilltarët që të edukohen për kompetencat e vetëqeverisjes lokale dhe rolet e tyre dhe për përgjegjësitë në atë.
  - Që të përmirësohet kapacitetet e këshilltarëve komunal, përmes trajtimit të detyrueshëm për të njohur me kompetencat e tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë, si këshilltarë;
  - Përmirësimi i kushteve për punë të këshilltarëve, duke siguruar një hapësirë të mjaftueshme për koordinim të këshilltarëve, për përgatitje para secilit takim dhe për konsultim me qytetarët;
- Kryebashkiakët dhe këshilltarët të kufizojnë qartë midis angazhimit të tyre në partinë politike dhe funksionit/pozitës brenda vetëqeverisjes lokale.

## 1. Organizatat qytetare (OQ)

- Organizatat qytetare duhet të krijojnë ekspertizën e vetë e kompetencave dhe mjeteve për pjesëmarrje të qytetarëve. Ato, gjithashtu, duhet ti edukojnë konstituentët e tyre për të drejtat e tyre dhe për mënyrat e realizimit të të drejtave të tyre.
  - Të përkushtojnë një vëmendje më të madhe edukimit aktual të qytetarëve për konceptin qytetar dhe përfshirje në miratimin e vendimeve
- Organizatat qytetare duhet të jenë proaktive gjatë komunikacionit të tyre me komunat dhe ta luajnë rolin e tyre të “vëzhguesve” për të rritur ndikimin e tyre. Ato duhet ti artikulojnë kërkesat e qytetarëve dhe ti dërgojnë deri te NjVL, sepse ato kanë përparësi gjatë përfaqësimit të interesave të tyre.
  - Në mënyrë të vazhdueshme ta ndjekë punën e autoriteteve lokale. Një vëmendje të posaçme të përkushtohet shpenzimeve buxhetore dhe të bëhet paralelë midis planifikuarit-realizuarit.
  - Të formojnë partneritete me mediat lokale përmes të cilave do të aktualizojnë problemet lokale dhe zgjidhjet
  - Të formojnë partneritete me organizatat e tyre qytetare nga vendi dhe rajoni për veprim të përbashkët
  - Ndarja e vazhdueshme e analizave të përgatitura nga organizatat qytetare deri te autoritetet lokale, trupat komunale dhe palët e tjera të përfshira
  - Organizatat qytetare në mënyrë proaktive ta ndjekin punën e Ndërmarrjeve publike dhe të marrin pjesë në krijimin e programeve
  - Mediat të informohen në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për punën e autoriteteve lokale. Më shpesh të organizohen emisione me debat me përfaqësuesit lokale ku mund të ekspozohen interesat e qytetarëve
- Organizatat qytetare (individualisht ose me qeverinë) duhet të përdorin aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe të bëjnë fushata publike që janë në lidhje me mekanizat dhe të drejtat e qytetarët që të përfshihen në procesin e miratimit të vendimeve. Ato duhet të dënojnë praktikat autoritare, në mënyrë jopartiake, dhe të dërgojnë një porosi se të gjithë njerëz janë të lirë dhe kanë të drejtën që të kërkojnë një jetë më të mirë.
  - Organizatat qytetare që të përkushtohen në ndërtimin e partneriteteve me autoritetet lokale duke ndarë ekspertizën e tyre, njohuritë dhe aftësitë në zgjidhjen e çështjeve prioritare në bashkësinë lokale

## 1. Agjencitë e donatorëve

- Politikat e donatorëve duhet ti ndryshojnë tendencat e tyre për dhënie e mjeteve përmes organizatave ndërkombëtare dhe në vend të kësaj, t'i transferojnë mjetet OQ-ve. Në kundërshtim, donatorët në mënyrë negative do të kontribuojnë për mirëmbajtjen e OQ-ve dhe me atë do të zvogëlohen mundësitë e tyre për të bërë përpjekje për interesat e qytetarëve dhe të drejtat si edhe që të fokusohen në detyrat e tyre kryesore.
- Përveç kësaj, gjatë financimit të investimeve të vetëqeverisjes lokale, veçanërisht investimet infrastrukturore, donatorët duhet të kërkojnë dëshmi të bindshme se këto aktivitete janë prioritet i qytetarëve. Ata, gjithashtu, duhet të përfshijnë vlerësimin e ndikimit të këtyre aktiviteteve të bashkësive, veçanërisht grupeve specifike shoqërore.
- Donatorët duhet ta kthejnë interesin e tyre për decentralizimin dhe ti mbështetin projektet që përfshijnë edhe aspektet infrastrukturore edhe ligjore të procesit.



Ky publikim është i pregaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Fondacionit për zhvillim të bashkësisë Shtip, Agjencia e Zhvillimit Lokal Strugë, dhe Qendrës për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësive Dibër dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron pikëpamjet e Unionit Evropian.